



KËSHILLI I SIGURIMIT, MINISTRI HASANI: SHQIPËRIA E PËRKUSHTUAR NË AVANCIMIN E PRIORITETEVE EDHE PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT

Në fjalimin e fundit në Këshillin e Sigurimit, në mbylljen e mandatit dyvjeçar të Shqipërisë si anëtar jo i përhershëm, MEPJ Iglj Hasani, theksoi se Shqipëria do t'i vijojë prioritetet e punës përtej mandatit. Ministri Hasani theksoi se Shqipëria zbaton të gjitha detyrimet për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të kontrollit të armëve, teksa nënvizoi se vetëm një bashkëpunim i fortë midis aktorëve të ndryshëm mund të ndihmojë në adresimin e duhur të kësaj situate. Gjatë vizitës së tij në Nju Jork, MEPJ Iglj Hasani zhvilloi një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të OKB, Antonio Guterres.



OKB, HASANI: RINIA PËRFAQËSON 100% TË SË ARDHMES SË SHQIPËRISË

MEPJ Iglj Hasani kryesoi takimin e Këshillit të Sigurimit, ku theksoi rëndësinë e fuqizimit të të rinjve në jetën politike dhe jo vetëm. Ministri Hasani u shpreh se të rinjtë janë ata që preken të parët nga konfliktet, teksa nënvizoi se fuqizimi i të rinjve mbetet thelbësor për arritjen e pajtimit dhe ndërtimin e paqes në rajon.



BRUKSEL, MINISTRI HASANI: GATI PËR MBAJTJEN E KONFERENCËS SË DYTË NËRQEVERITARE SHQIPËRI-BE

MEPJ Iglj Hasani, mori pjesë në Konferencën BE-Balkani Perëndimor, organizuar nga Miqtë e Evropës në Bruksel. Gjatë panelit për zgjerimin e BE, Ministri Hasani theksoi se Shqipëria i ka bërë detyrat e saj dhe është gati për hapin e radhës në rrugëtimin e saj drejt integritimit evropian.



SHQIPËRIA MERR KRYESIMIN E KARTËS A-5, HASANI: PRIORITET ZHBLOKIMIT TË NGËRÇIT PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS

Shqipëria merr nga 1 janari 2024, kryesimin njëvjeçar të Komisionit të Partneritetit të Kartës SHBA-Adriatike (A5). Gjatë ministerialit të A5 që u mbajt në Shkup të Maqedonisë së Veriut, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Iglj Hasani theksoi se duhet të marrë fund bllokimi i anëtarësimit të Kosovës në A5.



SHQIPËRIA MERR PRESIDENCËN E BSEC-UT

Më 15 dhjetor 2023, në Stamboll, u mbajt takimi i 47-të i Ministrave të Punëve të Jashtme të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi. Në fund të takimit pala turke dhe njëkohësisht kryesia aktuale e BSEC-ut, dorëzoi presidencën e BSEC-ut, duke ja kaluar palës shqiptare.



100 VITE MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE, MINISTRI HASANI: TURQIA PARTNER STRATEGJIK I PAZËVENDËSUESHËM I SHQIPËRISË

MEPJ Iglj Hasani mori pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Turqisë. Ministri Hasani vlerësoi marrëdhëniet diplomatike Shqipëri-Turqi, të cilat sipas tij janë një reflektim i miqësisë reale që ekziston mes dy popujve.



MINISTRI HASANI KONFERENCË PËR SHTYP ME GAZETARËT, LISTON PRIORITET E MEPJ PËR 2024

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Iglj Hasani, në një konferencë për shtyp në prag të fundvitit, foli për arritjet e derimëtanishme të diplomacisë shqiptare, teksa listoi edhe prioritetet për vitin e ardhshëm.

